



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 729, datë 07.12.2023**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT GENTI SHALA, PËR  
VITIN 2021**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Genti Shala, për vitin 2021”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Genti Shala, për vitin 2021”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
    - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
    - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
    - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
    - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
  2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

### 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

#### 1.A Njohuritë ligjore

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave*

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu, në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

- *Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes*

Gjyqtari i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar të rrethanave të fakteve të çështjes, përshkrim i cili zhvillohet duke iu referuar provave të administruara gjatë gjykimit

në shkallë të parë, por duke i analizuar ato në mënyrë të pavarur. Kështu, gjyqtari kujdeset që përshkrimin e rrethanave të çështjes ta realizojë duke integruar provat mbi të cilat fakti ekstrahohet. Në këtë mënyrë, faktet evidentohen lehtësisht në vendim.

Duke u nisur nga mënyra se si janë paraqitur rrethanat e çështjes në 8 vendimet e analizuara, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, gjykim penal themeli, seancë paraprake apo kërkesë penale në fazën e hetimit paraprake*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale, gjykim si shkallë e dytë mbi bazë ankimi*), faktet parashtrihen gjithmonë në pjesën e parë të pjesës përshkuese - arsyetuese të vendimit. Edhe pse në vendimet burim vlerësimi nuk rezulton një nën pjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes në përputhje dhe duke i integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht. Pavarësisht, nëse shkaqet e ankimit konsistojnë ose jo në përcaktimin e saktë të rrethanave të faktit, gjyqtari i përshkruan dhe analizon ato në çdo rast, duke bërë të qartë faktin në tërësinë e tij, për të vijuar më pas me analizën ligjore bazuar mbi shkaqet e ankimit. Vetëm në një rast gjyqtari nuk ka trajtuar faktet e çështjes, por është ndalur në rrethanat procedurale të saj, pasi gjatë gjykimit në shkallë të dytë, nga ana e prokurorit është paraqitur kërkesa për tërheqjen e kërkesës për ekstradim, në kushtet kur kjo kërkesë ishte tërhequr nga autoritetet italiane. Në këtë mënyrë, gjyqtari është ndalur në trajtimin kronologjik të ecurisë procedurale të çështjes, duke vlerësuar më pas prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes në përputhje me ligjin procedural.<sup>1</sup>

Gjyqtari kujdeset të trajtojë faktet e çështjes (*penale apo civile*) në mënyrë të pavarur nga sa kanë pretenduar palët dhe sa ka pranuar gjykata e shkallës së parë në vendimin objekt ankimi. Për këtë qëllim, ai zhvillon një analizë të plotë të provave të administruara, prej nga evidentohen lehtësisht faktet të cilat i shërbejnë arsyetimit ligjor në vendim.

#### ***-Identifikimi i natyrës së çështjes***

Referuar të gjitha vendimeve të analizuara, rezulton se natyra juridike e çështjes është e qartë. Megjithatë gjyqtari nuk ndalet në trajtimin e mëvetësishëm të saj, natyra juridike e çështjes, zbulohet rast pas rasti duke iu referuar mosmarrëveshjes në gjykim, si dhe ligjit të aplikuar për zgjidhjen e saj. Nga identifikimi i faktit juridik, gjyqtari konkludon për natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është familjare apo penale, si dhe institutin përkatës juridik (*urdhër mbrojtje, gjykim penal themeli, kërkesë për pushim procedimi, caktim mase sigurimi ...etj.*). Gjithashtu, ajo citohet edhe në pjesën hyrëse të vendimit përkatës.

#### ***- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm***

Identifikimi i saktë i natyrës së çështjes lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e saj. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari identifikon dhe herë pas here citon ligjin e zbatueshëm, duke evituar citimin e çdo dispozitë me natyrë procedurale apo materiale, që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (*i*) vendime civile dhe (*ii*) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e çështjes, konstatohet se:

<sup>1</sup>Vendimi nr.675, datë 15.12.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

(i) **Në vendimet penale**, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal objekt procedimi (*nenet 78/1, 130/a/4, 79, 278/1, 323/1, 300, 186 dhe 248 të K.Penal*).<sup>2</sup> Po ashtu, gjyqtari ka identifikuar dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të zbatueshme në rastin konkret si në lidhje individualizimin e dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*);<sup>3</sup> pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të pandehurit apo detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik (*nenet 59 dhe 63 të K.Penal*);<sup>4</sup> institutin e parashkrimit të ndjekjes penale (*neni 66 i K.Penal*);<sup>5</sup> në lidhje me përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit për të miturin në konflikt me ligjin gjyqtari i referohet Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (*neni 97 pika 2 të KDPM*).<sup>6</sup>

Në rastet e kërkesave gjatë hetimit paraprak apo çështjet e seancës paraprake, gjyqtari identifikon dispozitat procedurale penale të zbatueshme lidhur me kushtet e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, konceptin e dyshimit të arsyeshëm (*nenin 228 të K.Pr.Penale*), duke referuar në këtë rast edhe normat procedurale të posaçme për të mitur në konflikt me ligjin sa i përket kufizimit të lirisë së tyre, konkretisht *nenet 15, 81, 86 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur*, për të ligjëruar vendimmarrjen mbi masën e sigurimit personal të caktuar.<sup>7</sup> Në rastin e pushimit të procedimit penal gjyqtari identifikon dhe citon dispozitat procedurale në lidhje me pushimin e akuzës ose çështjes penale, kriteret formale të kërkesës për pushimin e çështjes dhe shqyrtimin e saj nga gjykata (*nenet 328, 329/a, 329/b, 329 i K.Pr.Penale*).<sup>8</sup> Në funksion të interpretimit të dispozitave si më sipër, gjyqtari ka identifikuar edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare, që përbëjnë burim të së drejtës, lidhur me parimin e procesit të rregullt ligjor (*neni 6 i KEDNJ dhe neni 42 i Kushtetutës*)<sup>9</sup> dhe të drejtat gjatë procesit penal, duke iu referuar aspektit procedural të gjykimit që lidhet me të drejtën e mbrojtjes (*neni 31/b/ç i Kushtetutës*).<sup>10</sup>

(ii) **Në vendimin civil**, me objekt lëshim urdhër mbrojtje, gjyqtari identifikon dispozitat ligjore të ligjit të posaçëm nr. 9669 datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, në funksion të arsyetimit ligjor dhe të zgjidhjes përfundimtare të çështjes. Në mënyrë me specifike, gjyqtari ndalet në nenin 1 të ligjit të posaçëm në lidhje me qëllimin dhe funksionin e ligjit për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave dhe lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje; në nenin 3 për të analizuar “dhunën” në kuptim të këtij ligji; në nenin 15 në funksion të provueshmërisë dhe diskrecionit të gjykatës në lidhje me lëshimin e urdhrat të mbrojtjes, sipas bindjes së saj të brendshme.<sup>11</sup>

#### **-Në lidhje me konfliktin e normave materiale apo procedurale:**

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

<sup>2</sup>Vendimet nr.649, datë 01.12.2021, nr.264, datë 01.06.2021, nr.48, datë 08.02.2021 dhe nr.483, datë 26.10.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>3</sup>Vendimi nr.264, datë 01.06.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>4</sup>Vendimi nr.48, datë 08.02.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>5</sup>Vendimi nr.649, datë 01.12.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>6</sup>Vendimi nr.483, datë 26.10.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>7</sup>Vendimi nr.924, datë 13.10.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>8</sup>Vendimi nr.649, datë 01.12.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>9</sup>Vendimi nr.649, datë 01.12.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>10</sup>Vendimi nr.238, datë 19.05.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>11</sup>Vendimi nr.37, datë 17.05.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

## KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin dhe analizën e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes***

Interpretimi i ligjit është ekskluziviteti i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### ***- Në lidhje me interpretimin e ligjit material dhe procedural të zbatueshëm:***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtari në përputhje me rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes objekt shqyrtimi si dhe shkaqeve të ngritura në ankim, referon, citon dhe interpreton norma të ligjit procedural dhe material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të arritura lidhur me zbatimin e tyre në zgjidhjen e çështjes. Në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet se:

- interpreton nenin 251 të K.Pr.Penale në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së arrestimit; interpreton në mënyrë sistematike nenet 228 dhe 229 të K.Pr.Penale lidhur me kushtet dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit, përshtatshmërinë e tyre, vlerësimin lidhur me konceptin e “*dyshimit të arsyeshëm*”. Gjithashtu për të vlerësuar kushtet e caktimit të masës së sigurimit dhe ligjshmërinë e arrestimit për të miturin në konflikt me ligjin, gjyqtari interpreton nenet 15, 81 dhe 86 të KDPM;<sup>12</sup>
- në funksion të vlerësimit të bazueshmërisë së vendimit për pushimin e çështjes penale, interpreton nenin 66 të Kodit Penal, duke analizuar natyrën e institutit të parashkrimit të ndjekjes penale, si një ndër rastet e pushimit të procedimit penal, duke referuar në parashikimet e nenit 328 të K.Pr.Penale që përcakton rastet e pushimit të akuzës ose çështjes;<sup>13</sup>
- interpreton dispozitat e ligjit të posaçëm nr. 9669 datë 18.12.2006 “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, në lidhje me funksionin, qëllimin, elementët e dhunës, si dhe nivelin e provueshmërisë së saj, interpretim që bëhet në përputhje me rrethanat e fakteve të dala gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe me provat e paraqitura gjatë gjykimit, si p.sh, deklaratimet e bëra para oficerit të policisë gjyqësore, vlerësimi i riskut të bërë nga policia, apo edhe pohimet e palëve;<sup>14</sup>
- interpreton nenin 31/b/ç të Kushtetutës lidhur me të drejtën e kujtudo për t’ju nënshtruar një procesi të rregullt dhe dinjitoz penal. Në këtë kontekst, gjyqtari analizon shkeljet e

<sup>12</sup>Vendimi nr.924, datë 13.10.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>13</sup>Vendimi nr.649, datë 01.12.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>14</sup>Vendimi nr.37, datë 17.05.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

konstatuara në gjykimin në shkallë të parë, lidhur me mosrespektimin e të drejtës së zgjedhjes së të pandehurit për tu mbrojtur, duke cenuar kohën dhe lehtësitë e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen;<sup>15</sup>

- në funksion të vlerësimit të shkakut të ankimit lidhur me pezullimin e ekzekutimit të vendimit, gjyqtari interpreton nenin 59 të K.Penal, duke analizuar kushtet dhe kriteret kryesore të parashikuara në ligj për aplikimin e tyre. Po kështu, interpreton në mënyrë literale nenin 63 të K.Penal në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të aplikuar dënimin alternativ atë të detyrimit për kryerjen e një pune në interes publik.<sup>16</sup>
- në funksion të kualifikimit të faktit penal, zhvillon analizën juridike të veprës penale “*Dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a i K. Penal,<sup>17</sup> veprave penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, “*Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit*” dhe “*Moskallëzim i krimi*” parashikuar nga nenet 287/1, 323/1 dhe 300 të K. Penal,<sup>18</sup> si dhe veprës penale “*Vrasja me paramendim*”, parashikuar nga neni 78/1 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive për secilën.<sup>19</sup>
- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante***

Në një prej vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari ka përdorur jurisprudencën relevante, në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht në analizën e konceptit të “*dyshimit të arsyeshem*” gjejnë pasqyrim konkluzionet e vendimit unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 të Gjykatës së Lartë, edhe pse konstatohet se nga ana e gjyqtarit ky vendim nuk është cituar në mënyrë eksplicite.<sup>20</sup>

#### ***- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës:***

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtari përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet si duke i përmendur ato shprehimisht, ashtu edhe nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur. Në mënyrë më specifike, rezulton si më poshtë:

- (i) në vendimin nr. 264, datë 01.06.2021, në funksion të caktimit të dënimit, gjyqtari citon *parimin e individualizimit të dënimit*;
- (ii) në vendimin nr. 238, datë 19.05.2021, gjyqtari *parimin e procesit të rregullt ligjor*, në drejtim të mos respektimit të së drejtës së zgjedhjes së të pandehurit për tu mbrojtur;
- (iii) në vendimin nr.649, datë 01.12.2021, lidhur me institutin e parashikimit të veprës penale, gjyqtari referon *parimin e ekonomisë së sistemit gjyqësor, si dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të pandehurit*;
- (iv) në vendimin nr.483, datë 26.10.2021, gjyqtari citon *parimin e proporcionalitetit në caktimin e dënimit*, duke sqaruar se dënimi penal është i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën penale, etj.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në

<sup>15</sup>Vendimi nr.238, datë 19.05.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>16</sup>Vendimi nr.48, datë 08.02.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>17</sup>Vendimi nr.264, datë 01.06.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>18</sup>Vendimi nr.48, datë 08.02.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>19</sup>Vendimet nr.483, datë 26.10.2021 dhe nr.238, datë 19.05.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>20</sup>Vendimi nr.924, datë 13.10.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore, parimet e përgjithshme të së drejtës dhe standardet e procesit të rregullt ligjor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.B Arsyetimi ligjor**

### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit***

#### **- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se gjuha e përdorur nga gjyqtari në vendimet gjyqësore burim vlerësimi është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë dhe e kuptueshme. Gjyqtari kujdeset të përdorë terminologji korrekte dhe teknike, aty ku është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në aktet e ekspertimit të realizuar nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.<sup>21</sup> Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe tregohet kujdes në shmangien e përdorimit të fjalëve fyese apo denigruese.

Karakteristikë e mënyrës së të shkruarit të vendimit gjyqësor është pasqyrimi i qartë dhe analitik i fakteve të çështjes dhe arsyetimit ligjor të çështjes, si dhe ndërthurja e fakteve me interpretimin e ligjit të zbatueshëm. Mënyra e shprehjes së mendimit juridik nga ana e gjyqtarit zhvillohet nëpërmjet një balancimi të të shkruarit në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë me ndërthurjen e argumenteve ligjore të cilat zhvillohen në mënyrë logjike dhe të lidhura me njëra tjetrën.

Sa i takon aspektit gramatikor, gjyqtari tregon kujdes dhe vëmendje për mënyrën e ndërtimit të fjalive dhe paragrafëve, duke respektuar rregullat e gjuhës shqipe. Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin.

Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve, përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsyetimit të vendimeve, reflekton qartësi dhe thjeshtësi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Në këtë mënyrë, vendimet janë të qarta dhe të kuptueshme, jo vetëm për njohësit e ligjit, por edhe për një lexues me njohuri mesatare.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit, mundësojnë

<sup>21</sup>Vendimet nr.238, datë 19.05.2021 dhe nr.483, datë 26.10.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë

lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Pjesët e vendimit përgjithësisht fillojnë me një fjali tematike, e cila shpreh idenë kryesore të mendimit të asaj njësie ose konkluzionin mbi të cilin shtjellohen argumentet mbështetëse. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuara më parë, por dëshmon qëndrueshmëri dhe rrjedhshmëri të paraqitjes së argumenteve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit***

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

#### ***- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimeve. Konkretisht, vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese - arsytuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe shkaqet e ankimit, të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur.

*Pjesa përshkuese - arsytuese* është e ndarë në disa nënpjesë (*edhe pse jo me tituj të përcaktuar si p.sh rrethanat e faktit, ligji i zbatueshëm, analiza juridike, nga mënyra e pasqyrimin të tyre, në vendim konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nëndarje*) në të cilën në mënyrë të detajuar analizohen: rrethanat e fakteve të çështjes, siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, rrethanat procedurale në gjykimin në apel dhe vlerësimi i gjykatës së apelit mbi shkaqet e ankimit, në të cilën gjyqtari merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe duke e



aplikuar atë mbi faktet e çështjes të provuara në gjykim, për të përfunduar argumentin me një konkluzion mbi bazueshmërinë ose jo të çdo shkakut ankimi. Në përfundim të pjesës përshkuese arsyetuese, paraqitet konkluzioni tërësor i gjykatës lidhur me bazueshmërinë ose jo të shkaqeve të ankimit, si dhe vlerësimin mbi vendimin e gjykatës së shkallës së parë objekt ankimi.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466/a të K.Pr.Civile (në vendimin urdhër mbrojtje) apo nenit 428 të K.Pr.Penale (në vendimet për çështjet penale), e drejta e palëve për të paraqitur rekurs ndaj vendimit, si dhe data e shpalljes së vendimit.

Referuar analizës së mësipërme, konstatohet se gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, zbaton rregullat e shkrimit ligjor, duke analizuar rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, argumentimin ligjor lidhur me shkaqet e ankimit, për të përfunduar me konkluzionin tërësor mbi bazueshmërinë e tyre. Gjithashtu, konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural përkatës. Konkretisht, vendimet civile përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe nenin 466 të K.Pr.Civile, ndërsa vendimet penale përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, duke ndjekur rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor. Gjyqtari përdor një metodologji të unifikuar në strukturimin e vendimit edhe pse në aspektin vizual jo gjithmonë është e dallueshme, metodologji e cila i jep rrjedhë logjike analizës dhe argumentimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### **1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik**

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballë gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjyqtarëve u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, për sa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.<sup>22</sup>

- **Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:**

<sup>22</sup>Vendimi i GJEDNJ, çështja *Hadjanastassiou vs Greqisë*, datë 16.12.1992, faqe 33.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se arsyetimi është i plotë dhe i qartë, me fokus në çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, referuar shkaqeve të ankimit, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material. Rezulton kujdesi i gjyqtarit në mënyrën e paraqitjes dhe analizë tërësore të fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet gjyqësore burim vlerësimi është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni për provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në vendimet burim vlerësimi, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes, analiza e faktit dhe ajo ligjore, zhvillohen në mënyrë logjike, duke paraqitur argumente për secilin shkak ankimi. Norma ligjore zërthehet sipas qëllimit, duke i dhënë përgjigje shkakut konkret të ngritur në ankim, pa zgjatje dhe konfuzion, në rrjedhë logjike me konkluzionin e arritur.

Gjyqtari zhvillon analizën juridike për çdo pretendim të ngritur në ankim, ku integron analizën e lidhjes shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, ligjit përkatës dhe mënyrën e aplikimit të tij në rrethanat konkrete, për të konkluduar mbi zgjidhjen përkatëse. Kjo analizë e integruar rezulton veçanërisht në disa vendime:

- në vendimin civil me objekt urdhër mbrojtje, gjyqtari analizon në mënyrë shteruese të gjitha shkaqet dhe pretendimet e palëve, duke analizuar për çdo pretendim të palëve dispozitat përkatëse materiale të ligjit të posaçëm (nr. 9669 datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar), në përputhje me rrethanat e faktit dhe provat e administruara. Gjyqtari analizon marrëdhënien shkak-pasojë, konkretisht, veprimet apo edhe mosveprimet e të paditurit dhe cenimin e integritetit moral fizik dhe psikologjik të paditëses, si pasojë e sjelljes të të paditurit, për të konkluduar se paditësja është dëmtuar psikologjikisht dhe si pasojë, nevojitet lëshimi i urdhrit të mbrojtjes;<sup>23</sup>
- analizon rastet e pushimit të çështjes, kriteret për paraqitjen e kërkesës dhe shqyrtimin e çështjes nga gjykata, analizon institutin e parashkrimit të veprës penale, duke analizuar se në zbatim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor parashkrimi përfaqëson instrumentin për të evituar abuzimin në lidhje me ndjekjen penale;<sup>24</sup>
- analizon garancinë kushtetuese të normuar në nenin 31/b/ç të Kushtetutës, lidhur me të drejtën e kujtudo për t'ju nënshtruar një procesi të rregullt penal. Në këtë kontekst gjyqtari pasi pasqyron faktet e çështjes dhe ecurinë procedurale të çështjes në shkallen e parë ka çmuar se vendimi objekt ankimi është bërë në shkelje të garancive kushtetuese të parashikuara;<sup>25</sup>
- analizon elementet e figurës së veprës penale (parashikuar nga nenet 278/1, 300, 323/1 të K.Penal), analizë e bërë në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim dhe fuqinë provuese të tyre, në analizë të provave, rrethanave faktike, shkaqeve të ngritura në ankim gjykata ka arritur në përfundimin se ndaj të pandehurve duhet të aplikohen alternativat e dënimit, pezullimin e ekzekutimit të dënimit duke u vënë në provë të pandehurin apo zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik. Në këtë kontekst gjyqtari jep përkufizimet e shërbimit të provës dhe punës në interes publik.<sup>26</sup>

Në tërësi arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës duke i dhënë përgjigje të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura nga palët, si dhe çështjeve me karakter procedural të vlerësuara të nevojshme për tu analizuar nga ana e gjykatës.

<sup>23</sup>Vendimi nr.37, datë 17.05.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>24</sup>Vendimi nr.649, datë 01.12.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>25</sup>Vendimi nr.238, datë 19.05.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>26</sup>Vendimi nr.48, datë 08.02.2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se shkaqet e ankimit merren në analizë nga ana e gjyqtarit dhe ju jepet në çdo rast përgjigje e argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

## KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Gjyqtari analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjesh, për të vijuar me analizën e koncepteve ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes, mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre mbi rastin në shqyrtim. Gjyqtari e zhvillon argumentimin e tij duke ndjekur logjikën e zhvillimit e marrëdhënies shkak-pasojë, si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për t’i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse që përbëjnë shkaqe ankimi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2021, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 209 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorive *Familjare me palë kundërshtare*, *“Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”* dhe *“Penale seancë parapake”*.

Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (59 çështje),<sup>27</sup> me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (209 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 28.2% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat nga burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 59 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se :

- (i) 10 çështje nga kategoria “*Familjare me palë kundërshtare*”, me objekt “*Lëshim urdhër mbrojtje*”, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor 15 ditor të parashikuar nga neni 21, pika 2 i ligjit nr. 9669/2006, i ndryshuar. Koha e gjykimit të tyre varion nga 28 deri në 105 ditë, me një mesatare vonese prej 66 ditë nga afati 15 ditor i parashikuar në ligj. Ndërkohë, evidentohet se në dy raste, konkretisht çështjet me numër rendor 2 dhe 4, i kanë kaluar gjyqtarit për gjykim me short në datat 18.01.2021 dhe 08.04.2021 dhe kanë përfunduar në datat 03.02.2021 dhe 28.04.2021, duke përfunduar gjykimin respektivisht për 16 dhe 20 ditë, duke u përlllogaritur ky afat nga dita e caktimit të çështjes me short. Tejkalimi i afatit ligjor me vetëm 1 apo 5 ditë, vlerësohet të jetë i papërfillshme, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit. *Sa më sipër, këto 2 çështje do të konsiderohen të përfunduar brenda afatit ligjor.*
- (ii) 2 çështje nga kategoria “*Kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak*”,<sup>28</sup> me objekt “*Ankim ndaj vendimit të mos fillimit të procedimit penal*”, të cilat kanë përfunduar tej afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga neni 291, pika 5<sup>29</sup> i K.Pr.Penale. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet me numër rendor 1 dhe 2 janë regjistruar përkatësisht në datat 23.12.2019 dhe 06.12.2019, ndërkohë vendimi është dhënë përkatësisht në datat 18.01.2021 dhe 22.02.2021. Ndërkohë evidentohet se një nga këto çështje, konkretisht çështja me numër rendor 2, i ka kaluar gjyqtarit për gjykim pas rishortimit, përkatësisht me shortin e datës 18.01.2021 dhe ka përfunduar në datën 22.02.2021, pra pas 35 ditësh nga caktimi i çështjes me short. Tejkalimi i afati ligjor me vetëm 5 ditë nga dita e caktimit të çështjes me short, vlerësohet i papërfillshëm në raport me numrin e çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari. *Sa më sipër, kjo çështje do të konsiderohet e përfunduar brenda afatit ligjor.*
- (iii) 20 çështje<sup>30</sup> nga kategoria “*Kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak*”, me objekt “*Zëvendësim mase sigurimi*”, cila sipas nenit 260/4 të K.Pr.Penale, duhet të kishte përfunduar për një afat prej 5 ditësh, rezulton që vendimet të jetë marrë për një afat prej 6 apo 7 ditësh, duke tejkaluar afatin ligjor vetëm me 1 ose 2 ditë. Tejkalime këto të cilat vlerësohen të jenë të papërfillshme, duke konsideruar edhe ditët e pushimit javor, të cilat ndikojnë në përlllogaritjen e afatit. *Sa më sipër, këto 20 çështje do të konsiderohen të përfunduar brenda afatit ligjor.*

<sup>27</sup>Çështjet të përfunduara jashtë afatit ligjor në tabelën nr.2 janë çështjet me numër rendor 1-10; në tabela nr.10 janë çështjet me numër rendor 4, 12, 14, 19, 25, 26, 41, 43, 46, 47, 50, 52, 66, 67, 69, 73, 81, 82, 83, 88, 89, 95, 97, 98, 101, 117, 125, 135, 140-146, 149, 150, 173, 174, 176, 179, 183, 188, 189; në tabelën nr.11 janë çështjet me numër rendor 1-3, 5, 10 dhe 11

<sup>28</sup>Po që në të dhënat statistikore të dërguara nga gjykata janë pasqyruar tek Tabela nr.11 “Çështje penale seanca paraprake”

<sup>29</sup>Neni 291, pika 5 i K.Pr.Penale parashikon se: “5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së akteve”.

<sup>30</sup>Çështjet me numër rendor 4, 12, 14, 46, 50, 52, 69, 73, 81, 82, 88, 95, 97, 98, 149, 150, 173, 176, 179 dhe 183 në tabelën nr.10

Në tërësi, nga 59 çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre (duke zbritur çështjet e analizuarra më sipër të cilat konsiderohen të përfunduara në afat), rezulton që gjyqtari ka përfunduar jashtë afatit ligjor 36 çështje ose 17% të çështjeve që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 12 pikë.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit ka argumentuar shkaqet që kanë ndikuar në numrin e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, duke parashtruar si shkaqe: (i) pakësimi i numrit të gjyqtarëve; (ii) rishortimi i çështjeve disa herë të disa gjyqtarëve; (iii) gjykimi në disa gjykata (iv) delegimet; (v) procedura e vettingut. Kryetarja në detyrë në mendimin e saj e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi si “Mbi mesatare”, duke u shprehur se nga ana e gjyqtarit është përballuar një ngarkese pune, si relator, më shumë se 200 gjykime në vit. Duke pasur parasysh vështirësitë që ka pasur gjatë vitit të vlerësimit të gjyqtarit (2021) siç janë largimi i disa gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, plotësimi i trupave gjykues me anëtar të ri (pas largimit të gjyqtarëve) ka bërë që gjykimi i çështjeve të filluara të zgjatet në kohë, rishortimi i dosjeve disa herë, kanë sjellë si pasojë vështirësi në gjykimin e çështjeve brenda afateve ligjore.

#### **KONKLUZIONI**

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Në përcaktimin e nivelit të pikëzimit konsiderohen në rastin konkret:

- i) ngarkesa e lartë e gjyqtarit si relator dhe anëtar (në total ka gjykuar 351 çështje si relator dhe 339 çështje si anëtar);
- ii) ngarkesa e shtuar e gjyqtarit për shkak të caktimit të tij për të gjykuar në gjykata të tjera të apelit, të ndryshme nga ajo në të cilin ai ushtron kontrollin, në total për 17 çështje (15 çështje në Gjykatën e Apelit Korçë dhe 2 çështje në Gjykatën e Apelit të Posaçëm për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar);
- iii) vetëvlerësimi i gjyqtarit lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- iv) numri i lartë i çështjeve me afat ligjor ku gjyqtari ka qenë relator pasi rezulton se ka përfunduar 209 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë rreth 60% të çështjeve të shqyrtuara prej tij në vitin 2021;

Sa më sipër, në analizë logjike të të dhënave statistikore gjyqtari pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se sa rezulton nga llogaritja matematikore dhe konkretisht me 15 pikë.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 17%, por ndërkohë gjyqtari ka përfunduar një numër tepër të lartë çështjesh si relator dhe 60% e tyre janë çështje me afat ligjor.

#### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të:

- (i) **5 çështje** tek tabela nr. 8, e kategorisë “*Penale krime*”, dhe konkretisht çështjet me nr. rendor 9, 31, 34, 49 dhe 62, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6 muaj për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim/9 muaj për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim, të parashikuar në pikën 5/g të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 i ish KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Nga këto çështje, ajo me **numër rendor 62** rezulton të jetë nxjerrë për gjykim në datën 25.05.2021 dhe ka përfunduar në datën 14.12.2021, për një kohëzgjatje prej 203 ditësh, ose 6 muaj e 23 ditë. Duke hequr periudhën e lejes vjetore në vitin 2021 (35 ditë), kjo çështje do të kishte përfunduar për 168 ditë, **pra brenda standardit minimal kohor të zbatueshëm.**
- (ii) **1 çështje** tek tabela nr.11, e kategorisë “*Seancë paraprake*” dhe konkretisht çështja me numër rendor 6, e cila ka përfunduar jashtë afatit 2 muaj të parashikuar në pikën 5/k të vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish-KLD, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.
- (iii) **4 çështje** tek tabela nr. 12, e kategorisë “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhëniet juridiksionale me jashtë*” dhe konkretisht çështjet me numër rendor 2, 5, 6 dhe 7, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 2 muaj të parashikuar në pikën 5/k të vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish-KLD, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Çështja **me numër rendor 4**, rezulton të jetë nxjerrë për gjykim në datën 20.10.2021 dhe ka përfunduar në datën 15.12.2021, për një kohëzgjatje prej 56 ditësh ose 1 muaj e 26 ditë, **pra çështja rezulton të ketë përfunduar brenda standardit minimal kohor.**
- (iv) **2 çështje** tek tabela nr. 14, e kategorisë “*Juridiksion fillestar*” dhe konkretisht çështjet me numër rendor 11 dhe 24, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 4 muaj të parashikuar në pikën 5/k të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 i ish- KLD, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Ndërkohë çështja me numër rendor 29, me objekt “Ndreqje e gabimit material në vendimin penal”, rezulton të jetë nxjerrë për gjykim në datën 09.02.2021 dhe ka përfunduar në datën 24.03.2021, për një kohëzgjatje prej 43 ditësh ose 1 muaj e 13 ditë, pra çështja rezulton të ketë përfunduar brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj të parashikuar në pikën 5/k të vendimit nr. 261/2 date 14.04.2010 i ish-KLD, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (10 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (142 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar rreth 7% të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor në Gjykatën e Apelit, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 7%, pavarësisht ngarkesës së lartë në punë, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdesin maksimal për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afateve të shkurtra dhe në 93% të tyre duke respektuar standardin minimal kohor.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet e lartë, duke u pikëzuar me 5 pikë.

## **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje**

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi, sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve. Konkretisht:

- (i) Në lidhje me çështjet e kategorisë “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 58.4 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muajsh.
- (ii) Në lidhje me çështjet e kategorisë “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 5 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muajsh.
- (iii) Në lidhje me çështjet e kategorisë “*Marrëdhënie pune*”, koha mesatare rezulton të jetë 28.4 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muajsh.
- (iv) Në lidhje me çështjet e kategorisë “*Penale krime*”, koha mesatare rezulton të jetë 65.7 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 apo 9 muajsh.
- (v) Në lidhje me çështjet e kategorisë “*Seancë paraprake*”, koha mesatare rezulton të jetë 94.1 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muajsh.
- (vi) Në lidhje me çështjet e kategorisë “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezulton të jetë 102.4 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muajsh.
- (vii) Në lidhje me çështjet e kategorisë “*Juridiksion fillestar*”, koha mesatare rezulton të jetë 29.8 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 apo 4 muajsh.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe zëvendëskryetarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se koha mesatare që i dedikohet kategorive të çështjeve të gjykuara gjatë vitit 2021 është më e shkurtër ose e barabartë me standardin e pranuar.

### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm më e shkurtër se ky afat për 5 nga 7 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për dy nga kategoritë e çështjeve “*Seancë paraprake*” dhe “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, duke u tejkualuar ky afat respektivisht me 34 dhe 42 ditë. Duke vlerësuar kategorinë e çështjeve për të cilat ky standard rezulton i tejkualuar, tejkalimi me 34 apo 42 ditë është i papërfillshme për ngarkesën e gjyqtarit dhe natyrën e standardeve orientuese (jo detyruese), për këtë tregues gjyqtari, bazuar në analizën logjike të të dhënave statistikore, pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore, duke u pikëzuar sipas Metodologjisë, me 5 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

## **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara si relator (351), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2021 (832, pa përfshirë çështjet e caktuara nga rishortimi) është rreth 42.18%, përqindje e cila sipas Metodologjisë, pikëzohet me 2 pikë.

Në formularin e integruar të vlerësimit, gjyqtari ka shpjeguar se shtimi i numrit të çështjeve të shortuara dhe të pa gjykuara nuk lidhet me pakësimin e gjykimeve nga ana e tij, por me uljen e numrit të gjyqtarëve të cilët shortohen çështjet.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo treguesin sasior të punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar në rastin konkret 150 çështje penale.<sup>31</sup>

Lidhur me rritjen e papritur të volumit të çështjeve evidentohet se gjatë vitit 2021, janë larguar nga detyra katër gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Tiranë, çka ka sjellë si pasojë rishortimin e çështjeve të tyre, duke shtuar numrin e çështjeve të caktuara gjyqtarit subjekt vlerësimi me 1669 çështje, çka ka rritur në mënyrë të menjëhershme ngarkesën e punës së gjyqtarit, ku vetëm gjatë muajve korrik-shtator 2021 i janë caktuar 1535 çështje,<sup>32</sup> pa përfshiri këtu çështje e caktuar me short.

Ndërkohë lidhur me treguesin sasior të punës së gjyqtarit, rezulton se, gjatë vitit 2021 ka përfunduar në total 351 çështje si relator, nga të cilat rreth 161 çështje penale dhe civile, duke tejkalar në këtë mënyrë standardin minimal të ngarkesës me 11 çështje, ose 7.3%.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, veçanërisht:

- (i) të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2021, 351 çështje si relator, nga të cilat 161 çështje penale dhe civile me palë kundërshtare, duke tejkalar treguesin sasior në fuqi sipas “Kritereve matëse të

<sup>31</sup>Në pikën 1, shkronjat h) të vendimit të KLD nr. 260/2011, parashikohet se: “ 3. Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë ...h. Gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës penale, si relator, jo më pak se 150 gjykime çështjesh penale...”

<sup>32</sup> Referuar të dhënave të dërguar nga Gjykata e Apelit Tiranë, “Formati i Raportimit tremujor, bazuar në vendimin e KLGJ nr.25, datë 07.02.2019” për periudhat tremujori i III dhe i IV të vitit 2021, dërguar në datat 20.10.2021 dhe 21.01.2022



veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së me 7.3 % vetëm për çështjet me palë kundërshtare;

(ii) ngarkesës së tij si anëtar (ka përfunduar 339 çështje në këtë cilësi);

(iii) numrit 16 të çështjeve të caktuara për të gjykuar në gjykata të ndryshme nga ajo në të cilën gjyqtari ushtron funksionin;

(iv) rritjen e papritur të volumit të çështjeve për shkak të rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të larguar nga detyra, në 6 mujorin e dytë të vitit që përbën periudhën e vlerësimit me 1669 çështje, të cilat përbëjnë rreth 66.7 % të totalit të çështjeve të caktuara gjatë vitit,

në projektraportin e vlerësimit ishte propozuar nga relatorja pikëzimi me 8 (tetë) pikë lidhur me këtë kriter.

Për këtë tregues vlerësimi gjyqtari parashtrroi kundërshtimet e tij, duke u shprehur se: “Rendimenti i përfundimit të çështjeve është llogaritur si raport midis çështjeve të përfunduara me ato të caktuara gjatë një viti kalendarik. Por situata në Gjykatën e Apelit Tiranë në vitin 2021 ka qenë e jashtëzakonshme. Gjatë këtij viti në këtë gjykatë kanë ushtruar detyrën vetëm 6 gjyqtarë. Për këtë shkak të gjitha çështjet e reja civile e penale janë ndarë në short vetëm midis këtyre gjyqtarëve, pa përfshirë këtu çështjet që janë rishortuar disa herë për shkak të largimit të gjyqtarëve. Referuar nenit 74 të ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve e Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për të matur aftësinë për të përballur ngarkesën në punë, vlerësuesi bazohet ndër të tjerash edhe në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore. Por përsëri sipas kësaj dispozite, vlerësuesi duhet të shmangë rrethanat, të cilat nuk varen nga magistrati dhe kanë efekt negative në rezultatet e vlerësimit. Këto rrethana po i parashtroj në mënyrë të përmbledhur :

- 1) Gjyqtari nuk mund të kontrollojë numrin e çështjeve që regjistrohen në gjykatë, aq më tepër në një gjykatë apeli ku nga 31 gjyqtarë kanë mbetur vetëm 6 gjyqtarë. Kjo shifër ndikon në llogaritje matematikore sepse zvogëlon rendimentin pavarësisht numrit të çështjeve që evadon gjyqtari.
- 2) Përgjatë vitit 2021 kam gjykuar 351 çështje si relator dhe 339 çështje si anëtar, pa përfshirë këtu çështjet që janë deleguar në gjykata të tjera. Ngarkesa ime totale e punës ka qenë 690 çështje të gjykuara, pasi angazhimi në trupa të tjerë gjykues është gjithashtu kohë pune dhe edhe pse nuk merret parasysh në rendiment, duhet të konsiderohet në pikëzimin, si një rrethanë që nuk varet nga magistrati sepse koha efektive e punës si relator shkurtohet nga angazhimi në trupa të tjerë gjykues.
- 3) Viti 2021 ka një specifikë tjetër. Për shkak të numrit të mbetur të gjyqtarëve në gjykatë, çështjet me afat ligjor shqyrtimi, kryesisht masat e sigurimit janë gjykuar sipas gatishmërisë vetëm nga 6 gjyqtarë. Këto çështje ashtu sikundër edhe ato penale me afat paraburgimi apo kërkesa për ekstradim, kanë pasur përparësi shqyrtimi. Nga tabela statistikore rezulton se per vitin 2021 kam gjykuar 189 kërkesa penale, të cilat përbëjnë ngarkesë të shtuar për gjyqtarin e Apelit dhe që sigurisht ndikojnë edhe në numrin e çështjeve me pale kundërshtare të nxjerra në gjykim.
- 4) Delegimi në gjykata të tjera zvogëlon kohën efektive në punë në Gjykatën e Apelit Tiranë, rrethanë kjo që nuk është në përgjegjësi e gjyqtarit, e që ka ndikuar në numrin e çështjeve që janë gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- 5) Rritja e papritur e numrit të çështjeve dhe kushtet e mësipërme të punës, në një Gjykatë Apeli me vetëm 6 gjyqtarë, e cila çështjet e themelit i shqyrton me 3 gjyqtarë, ka ndikuar dukshëm në treguesin e rendimentit. Konkretisht për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor më janë caktuar vetëm nga shorti i çështjeve të reja, 369 çështje, të cilat kam qenë në

*pamundësi objektive për t'i përfunduar, ndërkohë që vetëm nga rishortimi për gjithë vitin 2021 kam marrë 1669 çështje, ngarkesë që edhe pse nuk më është llogaritur në rendiment, ka ndikuar në numrin e çështjeve të zgjidhura. Nëse në rillogaritjen e rendimentit do të zbriten nga numri i çështjeve të caktuara 369 çështje, atëherë rendimenti do të dilte më i lartë.*

- 6) *Në këtë situatë jo të zakonitë pune, planifikimi i seancave gjyqësore dhe i dhomave të këshillimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, nuk ishte më përgjegjësi e ekskluzive e gjyqtarit relator, por ajo ishte e lidhur ngushtësisht me mundësinë e anëtarëve të tjerë të trupës gjyqësore për t'u angazhuar në planifikimet dhe gjykimet e çështjeve.*

*Sa më sipër, duke marrë parasysh edhe këto rrethana të bëra me dije prej meje, kërkoj që të ndryshohet pikëzimi im për këtë tregues nga 8 pikë në 10 pikë, pikëzim maksimal.*

Referuar vërtetimit me nr. 17599 prot., datë 05.12.2023 të paraqitur nga gjyqtari në mbështetje të kundërshtimeve të tij, rezulton se gjatë vitit 2021 gjyqtari ka pasur një ngarkesë prej 3731 çështje gjyqësore (civile dhe penale), nga të cilat 1230 çështje gjyqësore të mbaruar nga viti paraardhës, ndërkohë vetëm për periudhën 01.10.2021-31.12.2021 i janë caktuar me short 369 çështje të reja dhe 1669 çështje civile dhe penale të rishortuar.

Pasi dëgjoi relatoren e shqyrtoi kundërshtimet e gjyqtarit, Këshilli vlerësoi se të gjitha rrethanat e parashtruara nga gjyqtari qëndrojnë objektivisht dhe janë të ditura për Këshillin, lidhur me situatën në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm gjatë vitit 2021, situatë që ka sjellë pamundësinë objektive të gjyqtarëve për të nxjerrë për gjykim dhe për të gjykuar çështje me palë kundërshtare tej standardit minimal sasior. Gjyqtari e ka arritur standardin minimal për shqyrtimin e çështjeve me palë kundërshtare, por sikurse është parashtruar edhe në kundërshtimet e tij, vlerësohet se ankimet ndaj masave të sigurimit kanë qenë në një numër të konsiderueshëm, çka evidentohet edhe nga tabelat statistikore në dosjen e vlerësimit. Po kështu edhe angazhimi i gjyqtarit në trupa të tjerë gjykues, pasi ndryshimet ligjore të vitit 2021 janë shtrirë vetëm për një periudhë të shkurtër kohe gjatë secilës masat e sigurimit janë gjykuar me një gjyqtar (për një periudhë 6/mujore). Në rastin konkret vlerësohet se tejkalimi i standardit duhet të llogaritet mbi totalin e çështjeve të gjykuara nga ana e gjyqtarit, i tillë që referuar numrit total të çështjeve të gjykuara 351 çështje krahasuar me standardin minimal sasior prej 150 çështjesh, rezulton i tejkaluar me 100 %.

## **KONKLUZIONI**

Sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe shkaqeve që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarit të cilat lidhen me rritjen e papritur të numrit të çështjeve për shkak të pakësimit të numrit të gjyqtarëve (rindarja e çështjeve), ngarkesën e punës gjatë vitit të vlerësimit, rritjen e numrit të prurjeve për çështjet e reja të regjistruara në gjykatë përfshirë edhe çështjet e caktuara në gjykata të tjera dhe shkallën e lartë të angazhimit në trupa të tjerë gjykues për shkak të reduktimit të numrit të gjyqtarëve, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi nga ajo që rezulton nga analiza matematikore, pasi nga kjo e fundit, duket që rendimenti si tregues i aftësive organizative të gjyqtarit, është kushtëzuar në këtë rast nga fluksi i madh i prurjeve të çështjeve të reja, çka nuk është përgjegjësi e gjyqtarit dhe jo nga mungesa e produktivitetit të gjyqtarit në menaxhimin e kohës, planifikimin e organizimin e procesit gjyqësor.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtari pikëzohet me 10 pikë.*

#### **2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është si më poshtë:

- (i) për çështje të kategorisë “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” koha mesatare e arsytimit është 103 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile;
- (ii) për çështje të kategorisë “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*” koha mesatare e arsytimit është 37 ditë, **pra më e gjatë se afati procedural** 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile;
- (iii) për çështje të kategorisë “*Familjare me palë kundërshtare*” koha mesatare e arsytimit është 208.7 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile;
- (iv) për çështje të kategorisë “*Marrëdhënie pune*” koha mesatare e arsytimit është 151.2 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile;
- (v) për çështje të kategorisë “*Penale krime*” koha mesatare e arsytimit është 125 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale;
- (vi) për çështje të kategorisë “*Kërkesa penale të hetimit paraprak*” me objekt sipas nenit 228, 248, 249/6, 260 dhe 261 të K.Pr.Penale, koha mesatare e arsytimit është 52.6 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** 10 ditë i parashikuar nga neni 249 i K.Pr.Penale;
- (vii) për çështje të kategorisë “*Kërkesa penale të hetimit paraprak*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 119 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale;
- (viii) për çështje të kategorisë “*Seancë paraprake*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 179.9 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale;
- (ix) për çështje të kategorisë “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit koha mesatare e arsytimit është 129.7 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale;
- (x) për çështje të kategorisë “*Juridiksion fillestar*” koha mesatare e arsytimit është 68.03 ditë, pra **më e gjatë se afati procedural** i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe zëvendëskryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin “*Shumë të lartë*”, duke argumentuar se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 30 ditë, kjo rezulton nga statistikat e vendosura në dispozicion nga gjykata. Megjithëse në to përfshihet edhe koha që i nevojitet sekretares gjyqësore për printim, marrjen e firmave nga anëtarët e trupit gjykues, qepjen dhe dorëzimin e dosjes. Gjithashtu, gjyqtari parashtron se në kohën e arsyetimit të vendimit duhet të merret në konsideratë edhe kompleksiteti i çështjeve të gjykuara.

Në Kodin e Procedurës Penale, neni 382 të tij parashikohet se: “*1. Pas marrjes së vendimit bëhet arsyetimi i tij duke u bazuar në provat dhe ligjin penal, si dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues. 2. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. 3. Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. 4. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës*”.

Gjithashtu, në nenin 430/1, pika 4 dhe 5 të K.Pr.Penale, parashikohet se: “*Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. 5. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, sipas pikës 4, të këtij neni, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Në këtë rast njoftohet kryetari i gjykatës*”.

Në interpretim të këtyre dispozitave, rezulton se afati i arsyetimit të vendimeve në apel për çështjet penale është 30 ditë, ndërsa për çështjet që gjykohen nga Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ky afat mund të zgjatet edhe për një periudhë tjetër me rreth 30 ditë, pra duke shkuar me 60 ditë për shkak të natyrës së vështirë të çështjeve që gjykon kjo gjykatë. Ndërsa në pikën 5, të nenit 430/1 të K.Pr.Penale, është parashikuar se afati 30 ditor mund të zgjatet në raste përjashtimore, por në këtë rast duhet të njoftohet kryetari i gjykatës.

Pasur parasysh ngarkesën tepër të lartë të përballuar nga gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2021, ku rezultoi se ai gjatë periudhës së vlerësimit ka dhënë 351 vendime, angazhimin e tij si anëtar i trupit gjykues në gjykime të zhvilluara në Gjykatën e Apelit Tiranë, por edhe si e deleguar në gjykatat e tjera të apelit gjatë periudhës së vlerësimit 2021, të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vlerësohet se një situatë e tillë përbën rast përjashtimor që çon në zgjatjen e afatit të arsyetimit të vendimit, çka duket të jetë pranuar edhe nga kryetarja në detyrë, e cila e ka vlerësuar aftësinë e gjyqtarit për periudhën e vlerësimit “*shumë të lartë*”. Për sa kohë se nuk ka një afat maksimal deri kur mund të zgjatet ky afat, vlerësojmë të përdorim si analogji afatin 60 ditorë të përcaktuar për arsyetimin e vendimeve në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe në Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Nga analiza e të dhënave statistikore, rezultoi se:

- (i) Për çështje të kategorisë “*Penale krime*” koha mesatare e arsyetimit është 125 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale, si dhe më i gjatë se afati prej 60 ditësh;
- (ii) Për çështje të kategorisë “*Kërkesa penale të hetimit paraprak*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 119 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale, si dhe më i gjatë se afati 60 ditorë;
- (iii) Për çështje të kategorisë “*Seancë paraprake*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 179.9 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale, si dhe më i gjatë se afati 60 ditorë;
- (iv) Për çështje të kategorisë “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit koha mesatare e arsyetimit është 129.7 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale, si dhe më i gjatë se afati 60 ditorë;
- (v) Për çështje të kategorisë “*Juridiksion fillestar*” për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 68.03 ditë, pra më e gjatë se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg. 4 i K.Pr.Penale, si dhe më i gjatë se afati 60 ditorë, por duke qenë se ky afat është tejkaluar me vetëm 8.03 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm për vet ngarkesën e lartë në punë të gjyqtarit, për rrjedhojë ***kjo kategori do të konsiderohet e shqyrtuar brenda afatit ligjor.***

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, duke zbatuar në koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, rezultoi “*Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve*”. Duke konsideruar të dhënat që rezultojnë nga tërësia e burimeve të vlerësimit lidhur me (i) ngarkesën e lartë në punë të tij në cilësinë e relatorit dhe anëtarit, (ii) angazhimin e tij për gjykimin e çështjeve në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushton funksionin, (iii) angazhimin e tij në kohë në procesin e rivlerësimit kalimtar gjatë periudhës së vlerësimit, (iv) rritjen e papritur të volumit të çështjeve për shkak të rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të tjerë (ku rezulton se gjatë vitit 2021 i janë caktuar për shkak të rishortimeve 1619 çështje), në zbatim Metodologjisë së Pikëzimit, në projektraportin e vlerësimit ishte propozuar nga relatorja pikëzimi me 9 (nëntë) pikë lidhur me këtë kriter.

Për këtë tregues vlerësimi gjyqtari parashtrroi kundërshtimet e tij, duke u shprehur se: “*Gjatë vitit 2021 jam përpjekur maksimalisht që vendimet gjyqësore t’i arsyetoj në kohë. Datat e vendosura në statistika nuk pasqyrojnë datat efektive të dorëzimit prej meje të vendimit të arsyetuar. Vendimet janë arsyetuar në kohë dhe janë dorëzuar tek sekretarja, e cila ka kryer procedurën e marrjes së firmave prej kolegëve, si dhe për dorëzimin e dosjes në sekretari. Kjo kohë ka ndikuar dukshëm në të dhënat statistikore. Edhe zëvendëskryetarja e gjykatës e ka vlerësuar aftësinë time lidhur me këtë tregues shumë të lartë. Prandaj edhe për këtë tregues kërkoj të vlerësohem maksimalisht*”.

Kryetarja e gjykatës në detyrë, në Formularin e Integruar të Vlerësimit i ka vlerësuar shumë të larta aftësinë e gjyqtarit lidhur me këtë tregues, duke argumentuar se “Në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara, gjyqtari ka qenë gjithmonë shumë korrekt, duke respektuar jo vetëm afatin ligjor, por duke i dorëzuar ato në një kohë shumë të shkurtër”.

Gjyqtari bashkëlidhur kundërshtimeve ka paraqitur edhe vërtetimin nr. 17599 prot., datë 05.12.2023 lëshuar nga kancelarja e gjykatës ku parashtrohet se vendimet janë arsyetuar në kohë nga gjyqtari dhe janë dorëzuar tek sekretarja gjyqësore, e cila ka kryer procedurat për marrjen e firmave prej anëtarëve të trupës gjyqësore, si dhe procedurën e dorëzimit të dosjeve në sekretari, prandaj dorëzimet kanë zgjatur për shkak të ngarkesës së sekretares.

## **KONKLuzioni**

Për sa më sipër, lidhur me treguesin e kohës mesatare të arsyetimit të vendimit gjyqësor, gjyqtari pikëzohet me 12 pikë, duke konsideruar si faktorë që kanë ndikuar në këtë tregues, situatën në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, kohën e punës, ngarkesën tepër të lartë në punë të gjyqtarit (rezulton se ka përfunduar 351 çështje në cilësinë e relatorit dhe 339 çështje në cilësinë e anëtarit) rritjen e papritur të volumit të çështjeve në periudhën e vlerësimit (1619 çështje vetëm për shkak të rishortimeve), angazhimin e tij në gjykimin e çështjeve të caktuara në gjykata të tjera të apelit, si dhe impenjimin në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.<sup>33</sup> Ndërkohë vetë kryetarja në detyrë e ka vlerësuar “shumë të lartë” aftësinë e gjyqtarit lidhur me këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 12 pikë.*

## **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore**

### **2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive**

Referuar të dhënave statistikore të dërguar nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 2 seanca;
- (ii) për kategorinë “Familjare me palë kundërshtare” është 1.2 seanca
- (iii) për kategorinë “Marrëdhënie pune ” është 1.2 seanca;
- (iv) për kategorinë “Penale themeli” është 3.8 seanca;
- (v) për kategorinë “Penale seancë paraprake” është 4.4 seanca.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare, rezulton të jetë **3.5 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtari ka

<sup>33</sup>Procesi i rivlerësimit kalimtar për gjyqtarin Genti Shala rezulton se ka përfunduar me vendimin nr.30, datë 11.10.2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Në tre çështje për të cilat gjykimi ka përfunduar për më tepër se një seancë,<sup>34</sup> rezulton se shkak ka qenë mosformimi i trupit gjykues, mosparaqitja e prokurorit apo të pandehurit për arsye shëndetësore, leninë kohë palëve për të paraqitur konkluzionet përfundimtare apo shpalljen e vendimit përfundimtar dhe jo mos marrja e masave organizative dhe procedurale nga ana e gjyqtarit relator. Pra, në tërësi konstatohet se seancat nuk janë zhvilluar në ditën e planifikuar për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarit. Ndërkohë, konstatohet se seancat gjyqësore janë caktuar në një distancë kohore 19 ditë, 28 ditë, 14 ditë, 7 ditë, 30 ditë, 28 ditë, 21 ditë, 13 ditë dhe 14 ditë;<sup>35</sup> 28 ditë, 23 ditë, 35 ditë, 14 ditë dhe 5 ditë;<sup>36</sup> 49 ditë, 35 ditë, 14 ditë, 14 ditë, 16 ditë, 14 ditë, 28 ditë, 14 ditë, 8 ditë, 6 ditë dhe 7 ditë.<sup>37</sup>

## **KONKLUZIONI**

Sa më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 3.5 seanca (ky numër tejkalohet vetëm me 0,5%) dhe në kushtet kur gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë vlerësohet me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, aftësia e gjyqtarit vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se, përgjithësisht në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët.<sup>38</sup> Rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (*neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi. Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë, pa pjesëmarrjen e të

<sup>34</sup>Çështjet e përfunduara me vendimet nr. 264, datë 01.06.2021, nr. 48, datë 08.02.2021 dhe nr. 238, datë 19.05.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>35</sup>Çështja e përfunduar me vendimin nr. 264, datë 01.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>36</sup>Çështja e përfunduar me vendimin nr.48, datë 08.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>37</sup>Çështja e përfunduar me vendimin nr.238, datë 19.05.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>38</sup>Neni 426 i K.Pr.Penale

pandehurit por në praninë mbrojtësit referuar nenit 416/a dhe 351 të K.Pr.Penale,<sup>39</sup> shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë në 6 çështjet e përzgjedhura me short*), dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*).

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa që shkojnë deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme e që lidhen me kushtet e punës. Megjithatë konstatohen dy seanca<sup>40</sup> të filluara me 54 dhe 51 minuta vonesë nga ora e planifikuar, por nuk konstatohet që fillimi me vonesë i seancës të jetë bërë shkak për dështimin e seancës gjyqësore. Po kështu, evidentohet se seancat gjyqësore janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur në procesverbalin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.*

## **2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore**

### **2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet në dosje janë renditur në mënyrë të rregullt, duke ndjekur kryesisht rendin kronologjik (sipas datës së aktit). Renditja e dosjeve gjyqësore është e rregullt dhe dokumentet janë lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur aktin e shortit, njoftimet e palëve, kërkesat e tyre dhe konkluzionet me shkrim aty ku ka të tilla, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, vendimin e arsyetuar.

## **KONKLUZIONI**

Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

<sup>39</sup>Çështja që i përket vendimit nr.48, datë 08.02.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë

<sup>40</sup>Shih dosjen që i përket vendimit nr.264, datë 01.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë



**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimi gjyqësor përfundimtar i arsyetuar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesat e palëve për shtyrjen e seancës, diskutimet përfundimtare të palëve).

#### **KONKLUZIONI**

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
97	Shkëlqyeshëm

### **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### **3.A Etika në punë**

##### **3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, rezulton të jenë regjistruar dhe trajtuar nga ana e ILD-së 9 (nëntë) ankesa,<sup>41</sup> si vijon:

<sup>41</sup>Në informacionin e dërguar nga ILD me shkresën nr.3346/1 prot., datë 23.12.2022 rezulton se për periudhën e vlerësimit për gjyqtarin janë paraqitur 10 (dhjetë) ankesa, ndërkohë referuar vendimeve të dërguara

- (i) Në ankesën e shtetasit A.B, të regjistruar në ILD me nr.1901 prot., datë 02.04.2021, ngrihen pretendime për veprimtarinë e disa magistratëve, ndër ta edhe për gjyqtarin Genti Shala. Lidhur me gjyqtarin Genti Shala ankuesi ngre pretendime se trupi gjykues nuk mori parasysht provat e paraqitura duke shkelur të drejtat kushtetuese. Pas shqyrtimit fillestar ILD me vendimin nr.1901/3 prot., datë 06.05.2021 ka vendosur arkivimin e ankesës, me arsyetimin se shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor është atribut i pushtetit gjyqësor dhe kjo kompetence e gjykatës nuk mund të zëvendësohet me hetimin disiplinor që është i një natyre krejt të ndryshme nga ajo e zgjidhjes në themel të çështjes.
- (ii) Ankesa e shtetasve D.K dhe S.K., e regjistruar në ILD me nr.2301 prot., datë 10.05.2021, konsiston në pretendime se Gjykata e Apelit Tiranë, me trup gjykues të përbërë ndër të tjerë prej gjyqtarit Genti Shala, ka dhënë një vendim të nxituar dhe pa pyetur dy mjekët ekspert të cilët bënë rivlerësimin e masës mjekësore. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 2301/2 prot., datë 08.10.2021 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasit znj.D.K dhe z.S.K”*, me arsyetimin se ankesa nuk plotëson kriterin për pranueshmëri për shkak se është ankesë e përsëritur nga të njëjtët ankues dhe për të njëjta fakte, të trajtuara dhe arkivuara më parë nga ILD me vendimin nr.1903, datë 02.04.2021.
- (iii) Ankesa e shtetasit S.M., e regjistruar në ILD me nr.2563 prot., datë 31.05.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka ngritur pretendime për zvarritjen e gjykimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, duke mos e shqyrtuar ende çështjen nr.53801-01390-30-2020. Pas verifikimit të kësaj ankese, nga analiza e të dhënave të grumbulluara nga verifikimi, nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit ndaj magistratit Genti Shala, për kryerjen e shkeljes disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika1 , shkronja d), e ligjit nr.96/2016 dhe për këtë shkak Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr.2563/11 prot., datë 23.12.2021 *“Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. S.M”*.
- (iv) Ankesa e shtetasit E.D, e regjistruar në ILD me nr.1635 prot., datë 09.03.2020, konsiston në pretendime për zvarritje të shqyrtimit të çështjes penale të regjistruar në datën 13.02.2020. Pas verifikimit të ankesës, ILD me vendimin nr.1229 prot., datë 09.05.2022, ka vendosur arkivimin e ankesës, për shkak se vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes penale nr.52308-00306-30-2020, datë 13.02.2020 nr.3433 akti, është shkaktuar nga dorëheqjet dhe shkarkimet e gjyqtareve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret dhe magistrati Genti Shala ka qenë në pamundësi objektive dhe për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij për gjykimin e çështjes penale.
- (v) Ankesa e shtetasit Xh.K, e regjistruar në ILD me nr.226 prot., datë 26.01.2021, konsiston në pretendime për zvarritje të shqyrtimit të çështjes penale me nr.70100-01455-30-2019, të regjistruar në datën 05.07.2019. Pas verifikimit të ankesës, ILD me vendimin nr.1856/3 prot., datë 26.07.2022, ka vendosur arkivimin e ankesës, për shkak se vonesat e pretenduara nga ankuesi janë rrjedhojë e faktorëve të tjerë të pavarura nga vullneti i magistratit. Gjyqtari rezulton të ketë ndjekur të njëjtin rregull për të gjitha çështjet penal të së njëjtës natyre regjistruara dhe të shortuara atij në të njëjtën periudhë me çështjen e ankuesit.
- (vi) Në ankesat e shtetasve D.Xh, të regjistruara në ILD me nr.40 prot., datë 11.01.2021 dhe nr.40/2 prot., datë 13.04.2021, ngrihen pretendime për vendimmarrje të padrejtë, në shkelje të rëndë të ligjit procedural, në çështjen penale të përfunduar me vendimin 1066, datë 10.07.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Pas shqyrtimit fillestar të ankesave të

---

rezulton se 1 (një) prej ankesave nuk ngre pretendime ndaj veprimtarisë së gjyqtarit Genti Shala, konkretisht ankesat e paraqitura nga ankuesi Sh.R. me nr. 2097 port., datë 21.04.2021, ngre pretendime lidhur me veprimtarinë e gjyqtarit R.B.

bashkuara, ILD me vendimin nr. 40/4 prot., datë 19.05.2021 ka vendosur arkivimin e ankesave të bashkuar, me arsyetimin se shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor është atribut i pushtetit gjyqësor dhe kjo kompetence e gjykatës nuk mund të zëvendësohet me hetimin disiplinor që është i një natyre krejt të ndryshme nga ajo e zgjidhjes në themel të çështjes. Referuar dispozitave të K.Pr.Penale, trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mos respektim të legjislacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor është kompetencë e gjykatave më të larta, në rast të ushtrimit të mjeteve procedurale të ankimit/rekursit ndaj vendimit gjyqësor.

**(vii)** Në ankesën e shtetasit I.T., të regjistruar në ILD me nr.1784 prot., datë 23.03.2021, ngrihen pretendime për veprimtarinë e disa magistratëve, ndër ta edhe për gjyqtarin Genti Shala. Ankuesi ngre pretendime për shkelje të rënda ligjore në shqyrtimin e çështjes penale me objekt "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese". Pas shqyrtimit fillestar ILD me vendimin nr.3129 prot., datë 08.07.2021 ka vendosur arkivimin e ankesës, me pretendimet e ankuesit në thelb janë pretendime të cilat lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe vlerësimit të provave nga gjykata respektive. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor, është atribut i pushtetit gjyqësor.

**(viii)** Në ankesat e shtetasit H.K., të regjistruar në ILD me nr.4029 prot., datë 02.11.2021 dhe nr.4029/2 prot., datë 08.11.2021, ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit Genti Shala, lidhur me vendimin nr.948, datë 13.10.2021. Pas shqyrtimit fillestar me vendimin nr.872 prot., datë 08.04.2022 ILD ka vendosur arkivimin e ankesave të bashkuara për shkak se referuar natyrës së pretendimeve të parashtruara, ankesa nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të parashikuar nga nenin 120, pika 1, shkronjat "d" dhe "dh" të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**(ix)** Ankesa e shtetasit H.M., e regjistruar në ILD me nr. 3019 prot., datë 30.06.2021. Përmes kësaj ankese, ankuesi ka ngritur pretendime se Gjykata e Apelit Tiranë, me trup gjykues të përbërë ndër të tjerë prej gjyqtarit Genti Shala, ka dhënë vendimin nr. 65, datë 19.05.2021, në vlerësim të gabuar të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, një vendimi të padrejtë dhe jashtë çdo norme morale dhe ligjore. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, duke vlerësuar se pretendimet e ankuesit për zbatim të gabuar apo mos respektim të legjislacionit procedural apo material janë kompetence e gjykatave më të larta, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 1099/1 prot., datë 01.08.2023 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga z. H.M".

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit. Nuk evidentohen që nga ana e gjyqtarit të ketë shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

Ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit, të cilat janë trajtuar nga ILD, nuk rezultojnë të kenë evidentuar elementë të cenimit të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Gjyqtari dhe zëvendëskryetarja e gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarit në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

## KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 35 pikë.*

### 3.B Integriteti i gjyqtarit

#### 3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, rezulton të jenë regjistruar dhe trajtuar nga ana e ILD 9 (nëntë) ankesa, të cilat janë evidentuar në treguesin më sipër. Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuar në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit. Nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën 825/24 prot., datë 18.10.2022, konkludohet se: a) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklarim të rremë; e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e tij.

## KONKLuzioni

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin, gjyqtari pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 40 pikë.*

### 3.C Paanësia e gjyqtarit

### 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

### 3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën 01 janar 2021 – 31 dhjetor 2021, është paraqitur vetëm 1 (një) kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit, e cila është rrezuar. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtari ka paraqitur 30 (tridhjetë) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 28 (njëzet e tetë) janë pranuar.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar dhënave burimore për ekzistencën e numrit të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtim (asnjë kërkesë e pranuar), numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “I pakonsiderueshëm”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

### 4.A Aftësia e komunikimit

#### 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, dhe i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet kujdesi i tij për të bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Gjyqtari dhe zëvendëskryetarja e gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.*

#### 4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

#### KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “E lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar**

##### ***4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtari dhe zëvendëskryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se gjyqtari gjithmonë ka shfaqur aftësi dhe disponibilitet për të bashkëpunuar me koleget dhe të angazhohet në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara juridike.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.*

##### ***4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari dhe zëvendëskryetarja e gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtari ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera**

#### ***4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari Genti Shala, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2021-31.12.2021, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit në 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithsej 6 ditë trajnimi.

Sipas parashikimeve të nenit 5, pika 3 të Ligjit për Statusin, *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret gjyqtari ka marrë pjesë në 6 aktivitete trajnuese të shtrira në 6 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e tij dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës penale.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitetet profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

#### **KONKLUZIONI**

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 6 aktivitete trajnuese të shtrira në 6 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimale (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara në Ligjin për Statusin.

*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh.M është 6 ditë në vit (brenda kufijve ligjore 5-40 ditë në vit), duke u pikëzuar me 20 pikë.*

#### ***4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, gjyqtari Genti Shala nuk ka marrë pjesë si ekspert/lehtësues në programe të trajnimit fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

#### **KONKLUZIONI**

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me



3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin Genti Shala, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për përfshirjen e tij në cilësinë e ekspertit/lehtësuesit në aktivitete të trajnimit vazhdues pranë SHM apo aktivitete të organizuara nga institucione/organizata të tjera, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë të dhëna konkrete për pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

#### **KONKLUZIONI**

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin Genti Shala, ky tregues pikëzohet me 3 pikë, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna konkrete në drejtim të tij.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.ç Publikimet ligjore akademike**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Ndërkohë, vetë gjyqtari në formularin e integruar të vlerësimit ka shpjeguar se nuk është angazhuar në këtë drejtim.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 (zero) pikë.

**Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për treguesin “Publikimet ligjore akademike”, gjyqtari pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

### NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	97	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	388	Shkëlqyeshëm

### REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari Genti Shala të plotësojë detyrimin ligjor për angazhimin e tij në procesin e trajnimit vazhdues dhe aktivitete të tjera për trajnimin e gjyqtarëve, në cilësinë e pjesëmarrësit apo lektorit, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**SHTOJCA 1**  
**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE**  
**NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN GENTI SHALA**  
**PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2021 - 31 DHJETOR 2021**

<b>1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT</b>			<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
			<b>100</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Treguesit</b>	<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë</b>	<b>Pikët</b>	<b>Të dhëna për metodologjinë</b>
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>97</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	15	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë

	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të dhënat statistikore</li> <li>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</li> <li>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</li> </ol>	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	<p><b>Koha mesatare:</b>  Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë  Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë  Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë  Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë  Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë</p>
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të dhënat statistikore</li> <li>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</li> <li>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</li> </ol>	+99 %	10	<p><b>Tej standardit :</b>  Nën 81 % - 2 pikë  Mbi 81-87 % - 4 pikë  Mbi 87- 93 % - 6 pikë  Mbi 93-99 % - 8 pikë  +99% - 10 pikë</p>
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të dhënat statistikore</li> <li>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</li> <li>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</li> </ol>	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	12	<p><b>Koha mesatare:</b>  Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë  Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë  Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë  Më e shkurtër se afati procedural</p>

					për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	<b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>

				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarit :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit:</b> Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Pikët total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>91</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>	<b>Burimi</b>	<b>Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit</b>	<b>Pikët</b>	<b>Metodologjia</b>	
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparencja e komunikimit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
<b>B. Aftësia për të</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b>



<b>bashkëpunuar</b>	bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave			E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	> 5 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë

<b>SIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>	<b>388</b>
<b>IVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>	<b>SHKËLQYESHËM</b>

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

